



Planuar / Dorezuar Puniljeno/Pridato Received/Delivety	06.04.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa e Protog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM4SHCK	1932/2022		1/3



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A. Nr. 184/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani kryetar Malsore Gashi – Bajraktari dhe Jeton Koca anëtarë, me Rushit Kajtazi –Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr 184/2022, të datës 28.02.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Burimi Komerc 6/6 mati 1, nga Komuna e Vushtrisë, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “ vlerësim i punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 06.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa A.nr. 184/2022, e datës 28.02.2022, e parashtruar nga ankuesi
- II. MBETET në fuqi, vlerësimi i rezultateve në punë, për vitin 2021, për nëpunësin Civil Liridon Keka, nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.
- III. Vendimi hynë në fuqi në ditën e ndëshkimit nga Kryetar i Kolegjit.

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 28.02.2022, me numër protokollit 1033/2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me vlerësimin vjetor për vitin 2021, të vlerësuar nga Udhëheqëses i Divizionit për Shërbime Private të Sigurisë, si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë më arsyetim se vlerësimi vjetor, është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në

Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.03.2022, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Punëve të Brendshme. Ndërsa me datë 18.03.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë të ankuesit si dhe shkresat lidhur me lëndën.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike ,për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e datës 28.02.2022, e parashtruar nga ankuesi me numër protokolli 1033/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; e- maili i datës 28.02.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021; e - maili i datës 02.02.2022; Ndryshimi dhe plotësimi i Akt Emërimit i datës 06.02.2017, me numër protokolli 118; Përshkrimi i detyrave të punës; Përgjigjeje në ankesë e datës 16.03.2022, me numër protokolli 349; Përgjigjeje në ankesë e datës 18.03.2022, me numër protokolli 1445/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, pjesërisht sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se vlerësimin e rezultateve në punë nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kolegji pasi ka analizuar pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë, si dhe gjitha prova dhe fakteve relevante ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë pjesërisht të bazuar, vetëm sa i përket anës së nënshkrimit të formularit nga ana e mbikëqyrësit, sepse mbikëqyrësi nuk e ka nënshkruar formularin, ndërsa ankuesi pasi nuk ka marr përgjigje në kërkesën e tij për rivlerësim me datë 09.02.2022 ka nënshkruar formularin e vlerësimit dhe ka njoftuar se nuk pajtohet me këtë vlerësim.

Bazuar në vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin, Kolegji konstaton se ankuesi është vlerësuar nga Udhëheqëses i Divizionit për Shërbime Private të Sigurisë, me notën e përgjithshme dy pike nëntëdhjetë e nëntë (2.99) prandaj bazuar në vlerësimi vjetor vlerësimi vjetor, Kolegji konstaton se një vlerësim i tillë është vlerësim i mirë dhe si të tillë Kolegji e lënë në fuqi konform nenit 13 paragrafi 4 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurat e Vlerësimit të Nëpunësve Civil..”, ndërsa sa i përket anës formale pas marrjes së këtij vendimi të gjithë palët e interesuar duhet ta konsiderojnë formularin e vlerësimit si në rregull proceduralisht

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr. 184/2022

Rushit KATTAZI

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit*
- *Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së,*

